



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

DREJTORIA E ARSIMIT

Save the Children në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe me Drejtorinë Komunale të Arsimit në Gjiçan, është duke implementuar projektin “Gjithëpërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në institucionet parashkollore, projekt i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë, shpall :

K O N K U R S

Vendi i punës : Një edukator mbështetës/gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja të veçanta

Institucioni : Shkolla fillore “ Thimi Mitko” në Gjiçan, grupi parafillor.

Qëllimi:

Edukatori do të punojë me fëmijët të grup-moshës 3-6 vjeçare duke përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta.

Kualifikimet dhe shkathtësitë themelore:

- Fakulteti i edukimit, (programi parafillor), shkolla e lartë pedagogjike (pedagogji speciale ose e përgjithshme) ose edukim relevant-programi përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijës.
- Të ketë njohuri për edukimin gjithëpërfshirës çështjet e edukimit të fëmijërisë së hershme, të drejtave të fëmijëve dhe të mbrojtjes së fëmijëve.
- Aftësi që të punojë në mënyrë të përshtatshme, fleksibile dhe efektive në punë ekipore
- Të kenë dëshmi për trajnimet e vijuar mbi edukimin gjithëpërfshirës me theks të veçantë për fëmijë me nevoja të veçanta .
- Të ketë kreativitet, strategji dhe metoda me fëmijë me nevoja të veçanta.

Përshkrimi i detyrave punuese :

Organizojnë mësimin sipas planprogramit mësimor të shkollës

- bashkëpunojnë me prindërit e nxënësve
- bëjnë përkujdesje prindërore ndaj nxënësve (në aspektin e edukimit , shëndetit, ushqimit, veshmbathjes, vendosjes dhe të ngjashme)
- marrin pjesë në punën e organeve dhe komisioneve profesionale
- udhëheqin dokumentacion pedagogjik
- kryejnë edhe punë tjera të cilat dalin nga procesi edukativ
- udhëheqin aktivitetet kulturore dhe punën argëtuese të nxënësve
- në mënyrë indirekte marrin pjesë në aktivitetet jashtëmësimore dhe jashtëshkollore
- organizojnë dhe mbajnë këshilla me nxënësit rreth kryerjes së detyrave të shtëpisë
- përforcojnë dhe i thellojnë njësi të caktuara mësimore dhe u japin njohuri të reja
- organizojnë gara sportive në bazë të planit
- marrin pjesë në punët e organeve profesionale të shkollës
- japin informata lidhur me suksesin, punën dhe jetën e nxënësve

- organizojnë dhe bëjnë vizita monumenteve të ndryshme kulturore
- bashkëpunojnë me arsimtarët që marrin pjesë në procesin edukativ
- organizojnë dhe marrin pjesë në të gjitha manifestimet të cilat shkolla i organizon
- bashkëpunojnë me arsimtarët e mësimi praktik dhe i dërgojnë nxënësit në mësimin praktik
- udhëheqin librin e kujdestarisë,
- janë përgjegjës për tërë veprimtarinë e shkollës gjatë kujdestarisë së tyre
- kryejnë dhe punë tjera që i cakton drejtori.
- **Për vendin e punës në fjalë nevojiten këto dokumente:** diploma mbi përgatitjen profesionale, kopja e letërnjoftimit, certifikatat për trajnimet e kryera adekuate (trajnimet e vijuara mbi edukimin gjithëpërfshirës me theks të veçantë për fëmijë me nevoja të veçanta), vërtetim mbi përvojën e punës, certifikatën e lëshuar nga sektori gjendjes civile , me të cilin dëshmohet vendbanimi i kandidatit, si dhe dëshmitë tjera. Të gjitha duhen të jenë kopje dhe nuk kthehen, ndërsa dokumentet origjinale prezantohet në intervistë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ, nr. 8/2010 të datës 22.06.2010, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Kohëzgjatja e kontratës: deri në përfundim të projektit.

Për këtë vend të punës, kandidatët do t'i nënshtrohen testit me shkrim dhe intervistës me gojë. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë testimin me shkrim, ftohen në intervistë me gojë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga shpallja në gazeta zyrtare dhe në mjetet e tjera të informimit .

Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në Gjilan.

Për vendin dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen përmes listës e cila do të vendoset në tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në objektin pranë Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

Komisioni do të bëjë selektim të aplikacioneve dhe në intervistë ftohen vetëm ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit.

Drejtori i drejtorisë

Bujar Nevzati